

Udhërrëfyesi turistik

Çdo person mund të veprojë dhe të ofrojë shërbime si udhërrëfyesh turistik ose të përdorë emërtimin "udhërrëfyesh turistik" në Republikën e Shqipërisë, vetëm nëse është pajisur me certifikatë sipas rregullores së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.692 datë 05.10.2016. Afati i vlefshmerise se certifikates se udherrefyeshit eshte 2 vjet, nga data e leshimit te saj, me te drejte rinovimi.

Kriteret për pajisjen me certifikatë:

1. Personi, i cili do të pajiset me certifikatën e udhërrëfyeshit turistik duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - a) Të jetë mbi moshën 18 vjec;
 - b) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
 - c) Të mos ketë qënë i denuar me heqje lirie për vepra penale të kryera me dashje;
 - d) Të jetë i pajisur me dokumentin që vërteton përfundimin me sukses të programit përkatës të kualifikimit të udhërrëfyeshit turistik, sipas kategorive dhe programeve të akredituara në përputhje me dispozitat e ligjit nr.93/2015, "Për turizmin".
2. Në rastin e një shtetasi të huaj, përveç plotësimit të kriterëve të përmendura më lart, ai duhet të jetë me qëndrim të ligjshëm, për jo më pak se një vit, në Republikën e Shqipërisë dhe të ketë njohuri bazë të gjuhës shqipe.

Procedura për marrjen e certifikatës

1. Kërkesa për marrjen e certifikatës

1. Kërkesa për pajisjen me certifikatë paraqitet në ministrinë përgjegjëse për turizmin, pranë së cilës funksion komisioni.
2. Për t'u pajisur me certifikatën e udhërrëfyeshit turistik, aplikuesi duhet të dorëzojë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kërkesën me shkrim, e cila duhet të përmbajë:
 - a) të dhënat e aplikuesit (emrin, mbiemrin, numrin personal, adresën e saktë, numrin e telefonit);
 - b) kategorinë e udhërrëfyeshit turistik, për të cilën kërkohet certifikata;
 - c) gjuhën ose gjuhët e huaja në të cilën udhërrëfyeshi do të ushtrojë aktivitetin e tij.
 - d) vendin, datën dhe nënshkrimin e aplikuesit.
3. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin, si më poshtë vijon:
 - a) Fotokopjen e letërnjoftimit ose pasaportës;

- b) Dëshminë e penalitetit, të lëshuar jo më herët se tre muaj përpara datës së aplikimit, e cila mund të paraqitet origjinale ose fotokopje e noterizuar;
- c) Fotokopjen e noterizuar të dokumentit të përfundimit të studimeve të arsimit të mesëm ose të lartë;
- d) Fotokopjen e noterizuar të dokumentit që vërteton përfundimin me sukses të programit të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik sipas kategorisë përkatëse;
- e) Dokumentin që vërteton njohjen dhe aftësitë komunikuese shumë të mira në gjuhën e huaj, në të cilën do të ofrojë shërbimet e tij udhërrëfyese turistik. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj duhet të jetë të paktën në nivelin B2, sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët.
- f) Vërtetimin për pagesën e tarifës së aplikimit, në shumën 500 Lekë.

4. Për shtetasit e huaj, përveç dokumenteve të sipërpërmendura, kërkesa duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Leja e qëndrimit e shtetasit të huaj në Republikën e Shqipërisë, e vlefshme për jo më pak se një vit;
- b) Dokument (certifikatë/dëshmi) që vërteton njohuritë bazë të gjuhës shqipe, të lëshuar nga një institucion i certifikuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.

2. Vendimi i Komisionit

Komisioni brenda 45 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës së aplikuesit ose nga data e paraqitjes së plotë të dokumentacionit, shqyrton dokumentacionin e plotë dhe merr vendim për lëshimin ose jo të certifikatës së udhërrëfyesit turistik.

3. Lëshimi i certifikatës dhe i dokumentit identifikues

Brenda 5 ditëve, nga data e vendimit të Komisionit, udhërrëfyesit i lëshohet certifikata dhe dokumenti identifikues për kategorinë dhe gjuhën përkatëse.